



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:186064

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05456424

C.nr.88/18

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtar Jashar Gashi, në çështjen kontestimore të paditësit B.... B....., nga fshati D....., Komuna e Klinës të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat B.... A....., nga Peja, kundër të paditurit M..... (V...) V..., nga fshati P..... Komuna e K.... tani me vendbanim në fshatin K.... Republika e S....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.... T....., nga K....., sipas padisë për Vërtetim pronësie, në seancën publike të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 28.02.2024, mori ndërsa me datë 14.03.2024, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

- I. REFUZOHET si e pabazuar padia e paditësit B.... B....., nga fshati D.... Komuna e Klinës, më të cilën ka kërkuar që të “VËRTETOHET se paditësi është pronar dhe posedues i ngastrave kadastrale nr. P-71011027-00001-108, në sipërfaqe prej 0,37.90ha, P-71011027-00001-132, në sipërfaqe prej 0.20.49 ha, P-71011027-00001-202, në sipërfaqe prej 02.26.60 ha, P-71011027-00001-203, në sipërfaqe prej 0.58.50 ha, P-71011027-0001-207, në sipërfaqe prej 0.29.88 ha, P-71011027-00111-4, në sipërfaqe prej 0.36.52 ha dhe ngastrës kadastrale me nr. P-71011021-00107-0, në sipërfaqe prej 1.05.28 ha të evidentuara në ZK P.... i P..... në bazë të shitblerjes. OBLIGOHET i padituri M.... (V...) V....., nga fshati P....Komuna e Klinës tani me vendbanim në fshatin K....R.... e S....., që paditësit B..... B....., të i’a pranojë të drejtën e pronësisë në ngastrat kadastrale nr, P-71011027-00001-108, në sipërfaqe prej 0,37.90ha, P-71011027-00001-132, në sipërfaqe prej 0.20.49 ha, P-71011027-00001-202, në sipërfaqe prej 02.26.60 ha, P-71011027-00001-203, në sipërfaqe prej 0.58.50 ha, P-71011027-0001-207, në sipërfaqe prej 0.29.88 ha, P-71011027-00111-4, në sipërfaqe prej 0.36.52 ha dhe ngastrës kadastrale me nr. P-71011021-00107-0, në

sipërfaqe prej 1.05.28 ha të evidentuara në ZK P..... dhe ta lejojë që kjo patundshmëri të çregjistrohet nga emri i tij dhe të regjistrohen në emër të paditësit B.. (...) B.... nga fshati D..... Komuna e Klinës, në Librat Kadastral pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Klinë, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

ARSYETIM

Paditësi B..... B....., përmes të autorizuarit të tij, me datë 24.03.2018, pranë kësaj gjykatë ka paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë kundër të paditurit M.....V....., nga fshati P....Komuna e Klinës.

Në padi i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësit nga i padituri me datën 29.07.2016, i ka blerë ngastrat kadastrale me nr. P-71011027-00001-108, në sipërfaqe prej 0,37.90ha, P-71011027-00001-132, në sipërfaqe prej 0.20.49 ha, P-71011027-00001-202, në sipërfaqe prej 02.26.60 ha, P-71011027-00001-203, në sipërfaqe prej 0.58.50 ha, P-71011027-0001-207, në sipërfaqe prej 0.29.88 ha, P-71011027-00111-4, në sipërfaqe prej 0.36.52 ha dhe ngastrës kadastrale me nr. P-71011021-00107-0, në sipërfaqe prej 1.05.28 ha të evidentuara në ZK P....i P....., në shumë prej 100.000 euro, me ç’rast paditësi ja ka paguar në tërësi të paditurit çmimin e kontraktuar të shitblerjes dhe prej atij momenti e gjerë më sot e mban në pronësi dhe posedim të qetë faktik.

Në shqyrtimin gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë, thënieve dhe parashtresave nga seancat e kaluara, me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor të kësaj çështje si dhe në tërësi pas përfundimit të të gjitha seancave të këtij shqyrtimi gjyqësor me rastin e analizimit të të gjitha provave të administruara deri më tani ka ardhur në përfundim që gjendja faktike e cila ka qenë e paraqitur në padi është vërtetuar plotësisht. Konsiderojmë se padia është e bazuar dhe se me administrimin e provave qoftë materiale apo me dëgjimin e dëshmitarëve B.... B..... dhe A.... T....., të gjithë kanë thënë se paditësi ja ka paguar çmimin e kontraktuar të paditurit për paluajtshmëritë kontestuese në vlerë prej 100.000 euro, siç janë të cekura në padi ka arritur që të vërtetohen në tërësi. Po ashtu edhe me dëgjimin e dëshmitarëve u vërtetua se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, pas

dëgjimit të dëshmitarit të parë B... dhe A.... nuk kam vërejtje për ta pasi që deklarata e tyre përputhet me deklaratën e paditësit edhe me provat tjera që gjinden në shkresa të lëndës veçanërisht me deklaratën e nënshkruar tek noteri në M... të Z..., e cila deklaratë është një provë e rëndësishme për këtë procedurë e cila argumenton që është kryer pagesa prej 100.000 euro, ndërsa dëshmitarët tjerë kam vërejtje pasi që të cilët nuk kishin njohuri rreth këtij kontesti, fjala është për dëshmitarët e propozuar nga i autorizuari i të paditurit, i propozoj gjykatës që të mos jua falë besimin dëshmisë së tyre. Po ashtu me provat që u administruan në këtë shqyrtim gjyqësor. Me provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor duke cituar dëshminë mbi pagesën e tërësishme të çmimit të vërtetuar te noteri K.... F.... me datë 29.07.2016, të aprovohet padia e paditësit si e bazuar dhe të vërtetohet se paditësit B.... B..... është pronar i paluajtshëm rive të cekura në padi në bazë të shitblerjes.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 325 euro, në emër të taksës gjyqësore 101 euro, për përfaqësim në 4 seanca të mbajtura 4647.50 euro (për secilën nga 422.50 euro) dhe për ekspertizë shumë prej 250 euro e në total shumë prej 5323.50.

E autorizuar e të paditurit në përgjigje në padi si dhe në parashtresën e datës 16.01.2024 ka theksuar se nga të gjitha provat e parashtruara gjykatës dhe dëgjimin e dëshmitarëve propozoj që gjykata në tërësi të refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar. Kjo nga arsyeja se nga veprimet e paditësit vërtetohet se nga fillimi ka shkuar në mashtrim duke vënë në lajthim djalin e të paditurit i cili ka pasur autorizim që të shesë patundshmërinë. Paditësi së bashku me M.... dhe L.....si dhe dëshmitarët M.....dhe M..... kanë shkuar tek avokati I. G... kanë lidhë marrëveshjen nga e cila shihet se çmimi i shitblerjes nuk është paguar dhe se patundshmëria e cila është lëndë kontesti nuk është shitur, sepse po të ishte shitur në Marrëveshje nuk do të ishte se kur të shitet t'ia paguajë paditësit 20,000.00 euro. L..... B.... ka qenë garantues sepse edhe ai ka patundshmëri të konsiderueshme në P..... të U.... Dëshmitarët të cilët i ka propozuar i autorizuari i paditësi ka të bëjë me vëllain e paditësit dhe dajën e paditësit të cilët as nuk kanë qenë në R.... qartë janë mësuar se si të dëshmojnë. Deklaratat se si paditësi i ka paguar çmimin e shitblerjes tek noteri është i pakuptimtë për çka paditësi do ti bartë të hollat përtej kufirit që pagesën ta bëjë në R..... me rrezikun që të hollat mund ti merren. Përse nuk ka propozuar që të hollat ti pagujë në Klinë e që deklarata të vërtetohet tek noteri në Klinë, e gjitha kjo është lojë me paramendim të paditësit, e kur është ballafaquar me L.... B..... dhe mesazhet të cilat i ka dërguar ka filluar që të paktën të marrë 20.000,00 euro nga djali i të paditurit sepse ka parë shqetësimin e tij. Për këtë konsiderojmë se gjatë procedurës të vërtetohet se paditësi në mënyrë të paligjshme me mashtrim

të vije deri te prona të patundshmërisë së madhe më shumë se 6 hektar edhe njëherë e theksojmë se kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e të paditurit ka theksuar se mbesin në tërësi pranë thënieve në shqyrtime, parashtrësës së datës 16.01.2024 dhe provave të nxjerrura nga momenti kur paditësi përmes të të autorizuarit të tij është lëshuar në shqyrtim sepse seancat paraprake të mbajtura në mënyrë që të paditurit i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm e për çka nuk ka pasur nevojë , nga arsyeja sepse paditësi ka pasuri njohuri mbi adresën e të paditurit si dhe të djalit të tij M..... Këtë paditësi e ka bërë me vetëdije për të mos i mundësuar të paditurit që të ofroj provat e tij e të cilat prova i padituri do të i prezantonte përmes të autorizuarit të tij më vonë. Paditësi e ka parashtruar padinë e regjistruar me numër C.nr.214/16, kundër të paditurit dhe të njëjtën e ka tërhequr me datën 29.03.2017, ku më pas është përpiluar marrëveshja e datës 31.03.2017, në prani të dëshmitarëve tek avokati L.. G....., nga Klina, ku në pikë II të marrëveshjes qëndron se deklaratën VR.nr.2535/2016 të datës 28.07.2016, V..... M.....e tërheqë që kjo deklaratë nuk mund të jetë lëndë në gjykatë që e njëjta nuk mund të prodhojë kurrfarë efekti juridik në të ardhmen për njërën dhe tjetrën palë. Në pikë II qëndron se kur patundshmëria e cila udhëhiqet në emër të M..... V.....të shitet e gjitha apo pjesë e pasurisë së tij L..... B.... të garantoj që M..... t'ia jap 20,000.00 euro. Paditësi në shqyrtimin e datës 18.10.2023, ka theksuar nuk e ka pasur deklaratën VR.nr.2535/2016 mbi dorëzim pranimin e çmimit të shitblerjes, por që më vonë e ka siguruar. Ku vërtetohet se M.....ka dashur që paditësit t'ia dorëzoj origjinalin e deklaratës së vërtetuar kur ti pranojë të hollat. Si e ka siguruar deklaratën origjinale paditësi ne nuk e dim e të cilën më vonë e ka keqpërdorur gjithashtu ka pranuar se është nënshkrimi i tij në marrëveshjen e datës 31.03.2017. Dëshmitari M....M..... me dëshmi në gjykatë ka pohuar përmbajtjen e marrëveshjes ku gjykatës i është dorëzuar një ekzemplar në origjinal. Pa marrë parasysh se paditësi e ka nënshkruar marrëveshjen e ka parashtruar prapë padinë e regjistruar me numër 88/18 duke propozuar përfaqësues të përkohshëm, për të vënë edhe gjykatën në lajthim se ka paguar çmimin e shitblerjes duke e shfrytëzuar deklaratën për pranim dorëzimit e të hollave tek noteri të përshkruar më lartë. Nga mesazhet të nxjerrura nga telefoni gjithashtu qartë shihet se çmimi i shitblerjes nuk është paguar. Në bazë të gjitha provave të nxjerrura dhe fakteve qenësore të vërtetuara në gjykim për këtë çështje juridike, i propozojmë gjykatës që në tërësi të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit Burim, për vërtetim të drejtës së pronësisë për patundshmërinë për ngastrat: 1-108 sipërfaqe 3790 m2, nr.1-132 sipërfaqe 2049m2, nr.102 sipërfaqe 22660 m2, nr.1-203 sipërfaqe 5850 m2, nr.1-207 sipërfaqe 3652 m2 dhe nr.107-0 sipërfaqe 10528 m2 të gjitha të përshkruara në ZK P.... i E.... si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, si për shpenzime të rrugës M..... nga K..... deri në gjykatë dhe anasjelltas 30 eurox5 gjithsej 150 euro dhe shpenzimet për të autorizuarin sipas tarifës së avokatëve.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: Çertifikata e pronës në emër të M..... V....., e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Klinë me datën 23.10.2017, certifikata e lindjes në emër të M..... V....., e lëshuar në Klinë me datën 20.02.2018, certifikata e lindjes në emër të M.... V....., e lëshuar në Klinë me datën 20.02.2018, deklarata mbi pagesën e çmimit të tërësishëm e të shitblerjes e vërtetuar tek noteri në R....., K.... F... me datë 29.07.2016, marrëveshja e lidhur në mes të B... B.... dhe L.... B....., e përpiluar me datë 31.03.2017, në Klinë si dhe e nënshkruar në prezencë të tre dëshmitarëve, raporti i ekspertit gjeodet A..... N....., i datës 30.01.2023, mesazhet ndërmjet B.... B..... dhe një personi me emrin L.... si dhe me emrin Milisav, data e mesazheve shihen si 27.10.2016, 30.07.2016, 23.01.2017, 30.12.2016, 15.03.2017, 22.02.2017 dhe 31.07.2016. dokumentet personale fotokopje të dëshmitarëve të dëgjuar në këtë gjykatë, deklarata e dhënë nga Milisav Vasiq e datës 21.03.2017 e dhënë pranë noterit në Rozhajë, autorizimet e palëve ndërgjyqëse për avokatët e tyre.

Pasi gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 te LPK-se arriti ne përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur sikur ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata pas analizimit të kërkesës së paditësit, administrimit të provave materiale të propozuara nga paditësi dhe dëgjimit të dëshmitarëve konstatoi se paditësi B... B....., kërkon nga gjykata që të vërtetoj pronësinë në bazë shitblerjes dhe se parcelat kontestuese rezultojnë të jenë të regjistruar në emër të paditurit Milivoje Vasiq.

Me certifikatën e pronësisë e lëshuar me datën 23.10.2017, u vërtetuar se ngastrat ngastrat: 1-108 sipërfaqe 3790 m2, nr.1-132 sipërfaqe 2049m2, nr.102 sipërfaqe 22660 m2, nr.1-203 sipërfaqe 5850 m2, nr.1-207 sipërfaqe 3652 m2 dhe nr.107-0 sipërfaqe 10528 m2 ZK-Pjetërq i Epërm, Komuna e Klinës që janë objekt kontesti evidentohen në emër të paditurit Milivoje Vasiq.

Nga deklarata e datës 29.07.2016, e regjistruar me nr.2535/2016 e noterizuar tek noteri Kozhar Feho në Rozhajë, e përpiluar në emër të djalit të të paditurit konstatohet se “unë Milisav Vasiq deklaroi se Burim Bytyqi, mi ka dhënë me datën 05.10.2012, ma pagoi shumën prej 100.000.00 euro me para të gatshme në dorë, për blerën e patundshmërisë e cila gjendet në Poterqin e Epërmë

dhe të Ulët, e cila evidentohet në librat kadastral të Komunës së Klinës, si parcelë kadastrale numër P-71011027-00001-108, në sipërfaqe prej 0,37.90ha, P-71011027-00001-132, në sipërfaqe prej 0.20.49 ha, P-71011027-00001-202, në sipërfaqe prej 02.26.60 ha, P-71011027-00001-203, në sipërfaqe prej 0.58.50 ha, P-71011027-0001-207, në sipërfaqe prej 0.29.88 ha, P-71011027-00111-4, në sipërfaqe prej 0.36.52 ha dhe ngastrës kadastrale me nr. P-71011021-00107-0, në sipërfaqe prej 1.05.28 ha”.

Nga marrëveshja e përpiluar me datën 31.03.2017 në Klinë në mes të paditësit Burim Bytyqi dhe Bogosavljeviq Lubisha, pranë avokatit Isa Gashi, u vërtetua se kjo marrëveshje është lidhur me vullnet dhe dëshirë të palëve ku të njëjtat me këtë marrëveshje përcaktojnë se objekti i kësaj marrëveshje është tërheqja e padisë dhe kërkesëpadisë me shenjen gjyqësore C.nr.214/16 e paraqitur në Gjykatën Komonale në Klinë nga paditësi Burim Bytyqi kundër të paditurit Milivoje Vasiq.

Tutje nga marrëveshja e lartcekur është vërtetuar fakti se palët janë dakorduar që Milisav Vasiq, deklaratën të cilën e kishte dhënë dhe nënshkruar në shenjen e regjistruar OVP nr.2535/2016, e noterizuar tek noteri Kozhar Feho, me datën 29.07.2016, të tërhiqet nga kjo deklaratë dhe kjo deklaratë nuk mund të jetë objekt për gjykatën dhe e njëjta nuk mund të prodhojë kurrfarë efekti juridik në të ardhmen për palët. Nga po kjo marrëveshje u vërtetuar fakti se palët janë dakorduar që kur Milivoje Vasiq, ta shet pjesën e tij të pasurisë së paluajtshme ose tërë pasurinë e paluajtshme e cila evidentohet më shërbim kadastral ZK Poterq i Ulët dhe i Epërm, pasi që kjo pasuri evidentohet në emër të Milivoje Vasiq ose nëse këtë pasuri e shet Milisav Vasiq, atëherë Lubisha Bogosavljeviq dorëzohet dhe pranon-garanto dhe merr përsipër obligimin që ti paguaj Burim Bytyqit shumën në vlerë prej 20.000.00 euro menjëherë pas shitjes së paluajtshmërisë së lartcekur.

Gjykata me propozim të palës paditëse ka dalë në vendshiqim së bashku me ekspertin gjeodet Arjanit Nrecaj, i cili në ekspertizën gjyqësore ka konstatuar se pas identifikimit dhe shiqimit në vend të paluajtshmërive të evidentuara si ngastra kadastrale me nr. të njëjsteve 1-202 S=(22660 m² sipas fletës poseduese), 1-203 S=(5850 m² sipas fletës poseduese) ZK Poterq i Ulët, në regjistrat kadastral evidentohet në emër të Vasiq Milivoje 1/1 dhe identifikuar ngastrat kadastrale 111-2 S=(2621 m² sipas fletës poseduese), 111-4 S=(3492 m² sipas fletës poseduese), 111-5 S=(2057 m² sipas fletës poseduese) ZK Poterq i Epërm, që në regjistrat kadastral evidentohen në emër të Vasiq Milivoje 1/1 dhe identifikimi i ngastrës kadastrale 107-0 S=(10528 m² sipas fletës poseduese) Zk Poterq i Epërm që në regjistrat kadastral evidentohet në emër të

Vasiq Milenko ¼, Vasiq DAorde ¼ dhe Vasiq Milivoje 2/4 parcela këto që shtrihen një Komunën e Klinës.

Gjykata ekspertizës së gjeodezisë ia ka falur besimin pasi që e njëjta ishte e punuar në mënyrë profesionale si dhe kishte mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata ka bërë dëgjimin e paditësit Burim Bytyqi, në cilësi të palës i cili në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.10.2023, ka deklaruar se me Milisavin djalit e të paditurit ka kontaktuar në zyrën e Buzhales në Klinë dhe në atë moment kanë filluar dhe kanë bërë pazarin me Milisavin i cili nuk e ka ditur shqipen ku aty prezent ka qenë edhe Lubisha, pazarin e kanë bërë në kafiterin Rio, pas kësaj bisede kanë shkuar tek noteri në Klinë Bedri Godanci, dhe pas bisedës me të ai iu ka thënë se kjo nuk bënë, Milisav ka thënë se nuk mund të pranoj para përmes bankës sepse ka obligim ndaj shtetit në Serbi, pastaj me propozimin e tij janë drejtuar në drejtim të Rozhajës tek noteri, kur kanë shkuar i ka thënë noteri Milisavit, çka je duke bërë je ka donë me shit tokën dy herë, në atë moment Lubisha, i ka thënë se pa i qit paret në tavolinë e po ashtu edhe noteri Feho, ka thënë se pagesa përmes bankës nuk mund të kryhet por të qiten senet në tavolinë dhe pastaj të kryhet, pastaj paditësi shumë prej 100.000 euro e kam qit në tavolinë shuma prej 50.000 ka qenë në bankënota ka 100 euro kurse shuma prej 50.000 kanë qenë bankënota preja 500 euro, pas pranimit të këtyre parave është nënshkruar dokumenti dhe kanë zbritur dhe i ka dërguar paret poshtë te kerri Milisavit, i cili ka ardhur dhe ka nënshkruar dokumentin për këtë deklaram si dëshmitar ka Agron Thaqi, Milisavim Lubisha Bogosavleviq dhe Blerim Bytyqi. Paditësi ka shtuar se çmimi i tërësishëm ka qenë 100.000 mijë euro për afërsisht 2 ha tokë e punueshme kurse mbi 3 ha janë pyll, në këtë çmim janë përfshirë të gjitha ngastrat, pagesa është kryer në zyrën e noterit Feho në Rozhajë, marrëveshja për shitblerje është bërë në kafiterin Rio. Tutje paditësi ka deklaruar se është e vërtetë se e ka tërheq padinë C.nr.214/2016 të datës 29.03.2017, pasi që nuk e kam pasur dokumentin e vërtetuar tek noteri në bazë të fjalës që ia ka thënë gjyqtari Ibrahim Shala, se pa dokument origjinal nuk mund të vazhdohet me kopje, pastaj kur ka shkuar tek noteri Feho, përmes avokatit Jakup Çeku, ka marr origjinalin dhe kanë ngritur padi të re dhe e kanë dorëzuar në këtë gjykatë. Nuk ka pasur marrëveshje tjetër me Lubisha Bogoslavleviq, përveç me të paditurin, nga Milisavi i ka kërkuar 20.000 euro sepse mi ka pasur borxh. Marrëveshja e datës 31.03.2017 është e nënshkruar nga paditësi dhe i kujtohet se aty prezent kanë qenë Mahir Maxhuni, Mendim Rama dhe Vasiq Milisav, por kjo marrëveshje ka të bëjë vetëm për shumë prej 20.000 mijë euro.

Gjykata ka bërë dëgjimin e Milisav Vasiq, i biri i të paditurit i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2016, e ka kontaktuar Vllado Shmigiq, në Krushevc që ti gjej blerës serioz dhe të ndershëm që ishte i interesuar të blejë tokë nga ai. Me datën 23.06.2016, është njoftuar me Lubisha Bogosavleviq në fshatin Poterq i Epërm, afër tokës së tij dhe në atë moment Vllada është kthyer në Klinë kurse ai me Lubishen dhe Burim Bytyqin kanë vazhduar në Kliqinë në një restorant, që të merren vesh për pazarin e tokës ku janë dakorduar për çmim prej 850 euro për një ari tokë e punues kanë qenë dikun 4 ha dhe 2 ha pyll, kur e kanë përfunduar janë kthyer në Klinë që të kryejnë procedurën e trashëgimisë kur e kemi përfunduar procedurën e trashëgimisë ka kaluar përafërsisht 1 muaj dhe e ka thirr Vlladi Shmigiq në Krushevc i cili e ka marr me veturën e tij nga Kryeshvci deri në Klinë, e më pas e ka thirr Burimin dhe i kishte thënë se Milisavi, ka ardhur dhe duhet me i përgatit parat. Burim Bytyqi po atë ditë kishte shkuar te Lubisha Bogosavleviq në fshatin Videjë dhe ishin marrë veshë që të nisen për Rozhajë që të nënshkruajnë deklaratën e pas asaj të ia deponojë të hollat në xhirollogari në bankë në Pejë ose Klinë. Më pas dëshmitari Milisav, ka deklaruar se paditësi Bytyqi ia kishte dhënë besën dhe i ka thënë në besim se do të ia sjell të hollat për shkak se pagesa përmes llogarisë së firmës ka tatim, kur kanë shkuar në Klinë kanë shkuar tek avokati Zef Marleku të cilit Milisavi ia ka dhënë autorizimin që mund të ia bart Bytyqit patundshmërinë pas asaj Burimi kishte shkuar në fshatin Dugojevë që të marr shumën e parave prej 480 000 mijë euro, kurse ai Lubisha dhe Vllado Shmigiq, kanë pritur në fshatin Videjë sepse Burimi iu kishte thënë se do ti sjell parat për 40 minuta kanë kaluar një orë më pas Vllada e ka thirr në telefon ku paditësi i ka thënë që do të vij për 10 minuta nëpërmjet fshatit Budisalc kur kanë pritur deri në orën 21:00 të mbrëmjes po as që është lajmëruar Burim Bytyqi, kurse Vllado Shmigiq, ka shkuar në shtëpinë e tij në Dresnik ndërsa ai me Lubishen kanë qëndruar tek shtëpia e Lubishes atë natë të nesërmen ka qenë ditë e shtune ditë jo pune dhe janë kthyer tek avokati Zef Marleku që të ia tërheq dokumentet avokatit dhe më pas ka shkuar me Vlladen dhe Lubishen për Krlevë. Dëshmitari ka deklaruar se më të arritur në shtëpi në Krushevc i ka ardhur një mesazh se Burim Bytyqi është burgosur me 500.000 euro me avokatin e tij, mesazhin ia ka dërguar vëllai i Burimit dhe kjo ka ndodhë me datën 30.07.2016 kurse me datën 02.08.2016 ka ardhur në Klinë dhe ka shkuar tek avokati Zef Marleku me ia tërheq autorizimin së bashku me Lubishen dhe Burimin, dhe pas një kohe paditësi pas shpine me datën 08.08.2016 ka paraqitur padinë e parë, pastaj vjen viti 2017 kur nga gjykata i ka ardhur thirrja në Klinë, dhe të njëjtën ditë të gjykimit palët kanë bërë një marrëveshje të cilën e kanë shkruar tek avokati Isa Gashi, që Milisavi të ia paguajë 20.000 euro kurse Burimi të tërheq padinë prej gjykatës dhe deklarata e tyre e nënshkruar tek noteri në Rozhajë mos më pas efekt juridik pastaj ka shkuar dhe ia ka sqaruar të gjitha rrethanat noterit se nuk i ka marrë parat dhe

nuk është kryer shitblerja më pas te noteri e ka bërë një deklaratë në formë të shkruar e cila është vërtetuar tek noteri Feho Kozhar në Rozhajë, qëllimi i kësaj deklarate ishte se paditësi ia kishte dhënë besën se do të ia bënte pagesën duke i thënë se për shkak se po që se bëhet pagesa përmes bankës do të paguhet tatim shumë dhe i njëjti i ka besuar. Në fund Milisav Vasiq, ka deklaruar se nga Burimi nuk e ka pranuar asnjë shumë asnjë euro.

Gjykata me propozimin e palëve dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të kësaj çështje juridike ka bërë deponimin e dëshmitarëve Blerim Bytyqi, Agron Thaqi, Mahir Maxhuni dhe Vllado Shmigiq.

Dëshmitari Blerim Bytyqi ka deklaruar se paditësin e ka vëlla, dhe në vitin 29.07.2016, ka qenë të Lulishtja në fshatin Qyshk afër Xhamisë, i ka pas me vete 50.000 mijë euro dhe prej aty kanë vazhduar rrugën për në Rozhaj, kanë qenë së bashku me dajën Agron Thaqi, pasi kanë mbri në Rozhajë kanë hy brenda në një lokal dhe kanë pritur 15 minuta ia kanë dorëzuar para Burimit në shumë prej 50.000 mijë euro dhe 50.000 mijë të tjera i ka pasur Burimi, pasi ia kanë dorëzuar parat Burimit, kanë dal jashtë dhe e ka njoftuar Burimin prej shtëpisë sepse noteri nuk e ka lënë mbrenda por i kujtohet se ka qenë prezent Milisavi, Lubisha dhe daja Agroni. Tutje dëshmitari ka deklaruar se Burimi ia ka paguar shumën prej 100.000 mijë euro Milisavit, duke shtuar se ka qenë prezent kur Burimi ia ka dhënë paret Milisavit dhe prezent kanë qenë edhe Agroni dhe Lubisha dhe pasi Burimi e ka nënshkruar kontratën kam dalur jashtë shumën prej 100.000 mijë euro Burimi ia ka dhënë Milisavit para noterit. Në fund ka shtuar se ai së bashku me Agronin është kthyer në shtëpi pasi kishte qenë me veturë tjetër kurse Burimi nuk e dinë me kënd është kthyer.

Dëshmitari Agron Thaqi, ka deklaruar se paditësin e ka si nip dhe se ka njohuri se Burimi ka blerë patundshmëri por prej kujt e ka blerë nuk e njehë dhe nuk e di çmimin vetëm e di se ka qenë në Rozhajë te një noter ku Burimi i ka thënë se kemi mi qu do pare në vlerë prej 100.000 mijë euro dhe kur kanë shkuar atje kanë nejt pak brenda po ma shumë nuk i kanë lënë i kanë qit jashtë. Pagesa ka qenë prej Burimit për një patundshmëri dhe një kontratë e di se një pjesë e kësaj patundshmërie gjindet afër përmendores në fshatin Poterq, dhe për pjesën tjetër nuk e dinë. Dëshmitari ka deklaruar se atë ditë sa e dinë ai është lidhë kontrata por Burimin nuk e ka parë duke ia dhënë parat Milisavit për shkak se nuk ka qenë nonstop aty pasi ka dal disa herë jashtë edhe pse ka qenë me Blerimin bashkë, kohë pas kohe ka dal edhe pa Blerimin, Milisavin nuk e njehë edhe pse ndoshta e ka parë tek noteri por nuk e ka mbajtur në mend se si ka qenë. Në fund dëshmitari ka shtuar se në shtëpi është kthyer me Blerimin kurse Burimi është kthyer me Kombi.

Dëshmitari Vllado Shmigiq, i cili ka deklaruar se i njehë Burimin dhe Milisavin por me asnjërin nuk është në gjini gjaku. Dëshmitari ka deklaruar se nuk e di saktësisht datën por rreth 7 vite e ka thirre Bashor Buzhala tani i ndjerë i cili i kishte thënë se a mund të vish dhe aty është njohur me Burimin dhe atëherë kishte filluar tregimi se a e njeh Milisavin, i njëjti është përgjigjur se nuk e njeh por mund ta dijë kush është dhe se do të tentojë ta gjej dhe kur ka ardhur deri te numri i telefonit si i kishte thënë Brashori, i ka treguar Milisavit, se e ki një blerës dhe nuk kanë kaluar shumë ditë dhe e kanë thirre në Klinë, aty e kanë thirre edhe Burimin e më pas është takuar me Burimin dhe me Milisavin në Poterqë aty ka filluar njoftimi si kojshi. Tutje dëshmitari ka deklaruar se Burimi dhe Milisavi i kanë thënë se je i lirë nuk ke nevojë me nejt më shumë rreth transaksioneve unë nuk e di ata pas asaj janë takuar por nuk më kanë ftuar kurse një ditë e ka thirre Milisavi dhe kanë dal në një kafe në Klinë ku Milisavi i kishte thënë se e kam shitur tokën por mundësisht me qenë ti prezent kur të mi numëron parat aty kanë qëndruar një kohë dhe e kanë prit Burimin po i njëjti nuk ka ardhur pastaj Lubisha ju ka thënë ejani tek shtëpia ime në fshatin Videjë dhe kanë qëndruar një kohë por Burimi nuk ka ardhur e më pas dëshmitari ka shkuar në shtëpinë e tij dhe çfarë kanë pasur këta tutje nuk e dinë. Në fund dëshmitari ka shtuar se Milisav i është ankuar se nuk ia ka dhënë parat Burimi, kurse me Burimin nuk ka kontaktuar, se çmimi siç i ka thënë Milisav ka qenë 400.000 mijë euro dhe se nuk ka qenë prezent kur është bërë marrëveshja për shitblerjen.

Dëshmitari Mahir Maxhuni, ka deklaruar është nënshkrimi i tij në marrëveshjen mes Milisavit dhe burimit ku ka qenë ai dhe Lubisha Bogosavëeviq i cili i kishte thënë se a mundesh të bëhesh dëshmitar që Milisavi me ja kthy Burimit 20.000 mijë euro sa e din ai për tu tërhequr një lëndë prej gjyqit dhe mos me pas lëndë gjyqësore më.

Gjykata i ka analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e palëve dhe të dëshmitarëve të dhëna në shqyrtim gjyqësor ashtu që dëshmitë të dëshmitarëve Milisav Vasiq, Mahir Magjuni dhe Vllado Shmigiq, ia ka falur besimin të njëjtat konsistoni me njëra tjetrën dhe kishin mbështetje në provat e administruara.

Kurse deklaratave të dëshmitarëve Blerim Bytyqi dhe Agron Thaqi, gjykata nuk ia fali besimin pasi që nuk ishin konsistente dhe nuk kishin mbështetje në asnjë provë materiale po ashtu duke e ditur raportin e afërt familjar me paditësin si dhe faktin se dëshmitari Blerim, në deklaratën e tij fillimisht deklaroi se parat ja kishte dorëzuar Burimit në një lokal sepse noteri nuk e ka lënë brenda por prezent ka qenë dëshmitari Agron, e më pas deklaroi ndryshe duke thënë se ka qenë prezent në zyrën e noterit kur Burimi ia ka dhënë parat Milisavit. Ndërsa ndryshe nga dëshmitari

Blerim i cili ka deklaruar se dëshmitari Agron ishte prezent në momentin e dhënies së parave në zyrën e noterit ky i fundit deklaroi se nuk e ka parë kur Burimi ia ka dhënë parat Milisavit pasi që ishin jashtë.

Sipas nenit 7 par. 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, më pas në bazë të nenit 319 par. 1,2 dhe 3 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, “Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”, “ Gjykata vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare”*, kurse në nenin 322 par 1, 2, të po këtij ligji përcakton se: *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”, “Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

Prandaj bazuar në dispozitat ligjore paditësi me asnjë provë nuk ka mundur ta vërtetojë faktin se të padituri ia ka bërë pagesën për shitblerjen e patundshmërive që janë objekt kontesti. Pretendimin e paditësit se ia ka paguar çmimin prej 100.000 mijë euro të paditurit duke konsistuar se ekziston deklarata tek noteri e nënshkruar nga Milisav Vasiq (i biri i të padituri) ku deklaroi se i ka pranuar të hollat nga paditësi dhe se po ashtu kur është bërë pagesa prezent kanë qenë dëshmitarët Blerim Bytyqi dhe Agron Thaqi, gjykata e ka vlerësuar si të pa bazuar dhe të pa mbështetur në asnjë provë materiale pasi që me marrëveshjen e datës 31.03.2017, paditësi ishte dakorduar që kjo deklaratë të tërhiqet nga Milisav Vasiq dhe e njëjta të mos prodhojë efekt juridik për palët në të ardhmen si dhe të mos mund të përdoret për lëndën në gjykatë. Po ashtu nga kjo marrëveshje është vërtetuar fakti se shitja e paluajtshmërive nuk ishte bërë pasi që në po këtë marrëveshje thuhet se pas shitjes së tërësishme apo të një pjesë të patundshmërive që janë objekt i këtij kontesti i biri të paditurit të ia paguajë 20.000 mijë euro paditësit Burim Bytyqit, me qëllim që i njëjti të tërheqë padinë e paraqitur C.nr.214/16.

Andaj gjykata pas administrimit dhe vlerësimit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke refuzuar padinë e paditësit për shkak të mungesës së provave pasi që paditësi me asnjë provë materiale nuk arriti të dëshmojë faktin se i ka blerë poatundshmlritë që janë objekt kontesti dhe se për të njëjtat të paguar çmimin e pretenduar e po ashtu as me dëgjimin e dëshmitarët nuk është arritur të vërtetohet një fakt i tillë.

Gjykata në procedurën e provave bëri shtjellimin e të gjitha provave të parashtruara nga ndërgjyqësit kurse në arsyetimin e aktgjykimit iu referuar vetëm provave që kishin ndikim vendimtarë në marrjen e vendimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 449, 450 të LPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në faktet e shtjelluara, provat e administruara e konform nenit 143 par.1, të LPK-së, vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PEJËS - DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.88/18, datë 14.03.2024.

Gjyqtari:

Jashar Gashi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese dhe atë në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.